

Poeti shqiptaro-amerikan, Gjokë Marinaj, promovon një libër poetik në Prishtinë

Shkolla amerikane e një poezie shqipe

Libri "Lutje në ditën e tetë të javës", i poetit shqiptaro-amerikan, Gjokë Marinaj, është vlerësuar nga kritikë letrarë si një model letrar që i tejkalon shabllonet e poezisë bashkëkohore shqipe

ARBEN VESELAJ
Prishtinë, 26 maj - Është promovuar të hënën në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitaret të Kosovës në Prishtinë libri poetik "Lutje në ditën e tetë të javës", i Gjokë Marinajt.

Nazmi Rrahmani, në cilësinë e botuesit, me rastin e promovimit, tha se kishte zgjedhur ta botonte librin poetik të Marinajt, për shkak të vlerave tashmë të dëshmuara që ka poezia e këtij poeti shqiptar që tashmë i ka kapërcyer kufijtë kombëtarë.

Për librin "Lutje në ditën e tetë të javës", një fjalë rasti e ka mbajtur poeti dhe publicisti nga Tirana, Mujë Buçpapaj. Ai ka thënë se, duke eksperimentuar "një lloj tjetër", poezia e Marinajt ka arritur të nxjerrë një model strukturalisht të qëndrueshëm, një poezi në të cilën mbi të gjitha dominon elementi filozofik. Buçpapaj i ka bërë një anal-

izë tërë përmbajtjes së librit të Marinajt, duke u ndalur sidomos të poezitë: "Antiportret i avancuar", "24 orë dashuri" etj., të cilat, sipas Buçpapajt, janë më të realizuarat në këtë libër.

Edhe kritiku Ramadan Musliu e ka cilësuar lart, jo vetëm poezinë e këtij libri, por edhe të librave pararendës të Marinajt. Ai, duke i bërë një analizë stilistike, tha se libri "Lutje në ditën e tetë të javës" mund të lexohet edhe si një traktat filozofik.

Prend Buzhala, publicist dhe kritik letrar, tha se libri poetik i Gjokë Marinajt për shumëçka është i veçantë në poezinë bashkëkohore shqipe. Për librin "Lutje në ditën e tetë të javës" ka folur edhe kritiku Ali Jasiqi, ndërkaq vetë autori, Gjokë Marinaj, në këtë promovim ka thënë se ky libër është fryt i kërkimeve të tij krijuese disa vjeçare.



Gjokë Marinaj

"Me dëshirë do të kisha dhënë më shumë, por s'kam mundur të bëj më shumë se kaq", tha Marinaj me modesti.

Botime të reja

Arben Hoxha "Kuptueshmëria e domethëniesve"

Libri i Arben Hoxhës

"Kuptueshmëria e domethëniesve" është i ndarë në pesë pjesë: Koncepte teoriko-letrare, Trajtime historiko-letrare, Imazhe



domethëniesh, Kode të hapësirës skenike-dramatike dhe Recensione, përkujtime. Në pjesën e parë, autori trajton konceptin e Aristotelit për epin, të Longinit për të madhërishtme, të Morisit për semi-ologjinë, pastaj parimet e teatrit epik, etj.; në të dytën nocionet dhe konceptet në veprën "Fletore e Bektashinjet", idetë historiko-letrare të Faik Konicës, parimet metodologjike të Egrem Çabejt në veprën "Romantizmi në Europën jug-lindore dhe në literaturën shqiptare" etj.; në pjesën e tretë për romanin e Rexhep Qosjes "Një dashuri dhe shtatë faje", për librin me tregime të Teki Dervishit "Etje dhe borë", për poezinë shqipe të viteve '80, etj.; në pjesën e katërt për shfaqjet teatrore, ndërsa në të pestin kanë zënë vend recensione dhe përkujtime. E botoi Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 2008.

Ardian Haxhaj "Fundi i një misioni"

Romani i Ardian Haxhaj "Fundi i një misioni" temën e merr nga koha e Luftës së Dytë Botërore. Por, ky autor i ri dhe i talentuar, personazhet nuk i merr nga sfera e luftës, po nga ajo e arsimit. Dihet se Lufta e Dytë



Botërore popullit shqiptar, të mbetur jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë (1913), përveç të këqijave që sjell çdo luftë, i solli edhe arsimit në gjuhën amtare, si dhe një komunikim pothuaj mbarëkombëtar, të munguar gjër në këtë kohë. Haxhaj me mjeshtri depërton në këtë kohë, në bartësit e saj dhe kështu krijon një prozë të mirëfilltë, jashtë çdo përpjekje për t'u inkuadruar në "izmat" që sot janë të modës. E botoi "Buzuku", Prishtinë, 2008.

Ministri i Kulturës, Valton Beqiri, e vendosi pllakën në Hamamin e Prishtinës

Hamami, thesar i Prishtinës

Në kuadër të programit për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, Ministria e Kulturës, Kuvendi Komunal i Prishtinës dhe Këshilli i Evropës vendosën një pllakë në Hamamin e Prishtinës, objekt ky i cili edhe simbolikisht vihet nën mbrojtjen e institucioneve

SHPEND ÇOÇAJ
Prishtinë, 26 maj - Vëndosja e pllakës në Hamamin e Prishtinës nga ministri i Kulturës, Valton Beqiri, kryetari i Kuvendit Komunal të Prishtinës, Isa Mustafa, dhe përfaqësuesja e Këshillit të Evropës, Edis Agani, e fut këtë objekt të trashëgimisë kulturore nën kujdesin e veçantë institucional. Ministri i Kulturës Valton Beqiri tha se Kosova e ka një thesar të pasur të vlerave të trashëgimisë kulturore, pjesë e së cilës është edhe Hamami. "Hamami është një ndër 25 objektet të cilat bëjnë pjesë në listën e objekteve prioritare për intervenim dhe është caktuar si objekti i parë ku do të vendoset kjo pllakë, e cila është pjesë e programit të përbashkët të Këshillit të Evropës dhe të Komisionit Evropian", tha

Beqiri. Kryetari i Komunës së Prishtinës, Isa Mustafa, e vlerësoi iniciativën dhe tha se Kuvendi Komunal i Prishtinës do të vazhdojë ta ruajë trashëgiminë kulturore. "Jemi munduar që edhe ne ta japim kontributin tonë si komunë dhe të ndajmë 200 mijë euro për rikonstruimin e këtij objekti", tha Mustafa. Edis Agani, përfaqësuesja e Komisionit Evropian, që e ka financuar këtë projekt, tha se ky është vetëm një hap i parë në kuadër të programit gjithëpërfshirës të trashëgimisë kulturore. "Hamami i Prishtinës nuk qëndron i vetëm, por ai është i rrethuar me monumente të tjera të trashëgimisë kulturore dhe duhet që e gjithë shoqëria e Prishtinës dhe e Kosovës të kënaqet me monumente të tilla",



Foto: AVNI UKA

tha Agani. Ajo tha se një qasje të tillë do të vazhdojë ta ketë Komisioni i Evropian në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, duke mbështetur edhe në të ardhmen, rehabilitimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore.

Universiteti "AAB" e nderoi Ramiz Kelmendin në 77-vjetorin e lindjes

Prishtinë, 26 maj - Një akademi solemne kushtuar 77-vjetorit të lindjes dhe 55-vjetorit të krijimtarisë letrare e publicistike të Ramiz Kelmendit e ka mbajtur të hënën universiteti "AAB" i Prishtinës. Në emër të këtij universiteti, një fjalë rasti e ka mbajtur Ilir Tafaj, ndërkaq, Xhavit Beqiri, i cili e ka përfaqësuar


Presidencën e Kosovës, ka folur për krijimtarinë në prozë të Ramiz Kelmendit. Studiuesi Emin Kabashi, në kumtesën e tij "Tipologjia e personazheve në prozën e Ramiz Kelmendit", ka folur për veçantitë gjuhësore të prozës së Kelmendit, për praninë e monologut, tipizimin e personazheve, ndërkaq person-

azhin e tij, Ahmet Koshutani, Kabashi e ka quajtur personazh model. Në fjalën e tij "Duke lexuar 'Kokrra kripe' të Ramiz Kelmendit", Masar Stavileci ka evokuar kujtime për shkrimet e rubrikës që dikur e kishte mbajtur Ramiz Kelmendi të gazeta "Rilindja". Kujtime nga takimet e para me shkrimtarin Ramiz Kelmendi

ka evokuar edhe akademik Alfred Uçi, ndërkaq publicisti Zenun Çelaj, në fjalën e tij, e ka vlerësuar lart kontributin e Ramiz Kelmendit, sa në letërsi, po aq edhe në fushë të gazetarisë. Shkrimtari Ramiz Kelmendi vijon të jetë aktiv si profesor në fakultetin e gazetarisë "Faik Konica" në Prishtinë. (a.veselaj)

Isuf Grajçevci "Hapat tu në mote"

Vëllimi poetik i Isuf Grajçevcit është i ndarë në katër cikle: Djepi i arbërit, Larg teje, Gjeth i tharë dhe Hapat tu në mote. Në cilin e parë poeti ka radhitur poezitë atdhetare, në të



dytin ato që janë të frymëzuara nga jeta në mërgim, në të tretin poezitë intime, ndërsa në të fundit poezi me motive të ndryshme. E botoi "Focus", Prishtinë 2008.